

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**



Referenca : 626/23/005/221

Në bazë të nenit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika(a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullorës 01/2022 për Prokurim Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 19.08.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “ARHIKO.ING” SH.P.K nga Prishtina, bie këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “ARHIKO.ING” SH.P.K nga Prishtina, e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 19.08.2023 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-23-6372-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-005-2-2-1 me titull ““HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”-Ritender”.

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik–“ARHIKO .ING SH.P.K., nga Prishtinë, më datën 19.08.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-s të dt:15.08.2023, anulimi e saj dhe lënda të kthehet në rivlesim , ku me këtë njoftim mbi vendimin e AK-s është përcaktuar përfituesi i tenderit me titull:“HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”-Ritender”.

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1, 7, 52, 56, 59, 60 dhe 65 të LPP-s si dhe neni 10 i Urdhëzuesit të Prokurimit Publik nr.001/2023.Konsiderojmë që të gjitha

këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe udhëzuesit, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

Operatori Ekonomik në pretendimin e parë, ka cekur se kinse ne kemi bërë shkelje të dispozitave të LPP-s konkretisht të nenit 1 duke pretenduar se kinse AK nuk ka përdor ligjin për të cilën bën thirrje në: sigurimin e mënyrës më efikase , më transparente dhe më të drejt të fondeve publike. Ky pretendim i dhënë nga O.E ankues nuk është i bazuar pasi që ne si AK gjithmonë thimemi në zbatimin e nenit 1 të LPP-s, pasi ligji ka përcaktuar qart se duhet të sigurojmë mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejt të fondeve publike, e këtë mendojmë se e kemi zbatuar në përpikëri që nga fillimi i procedurës deri në dhënjen e vendimit të AK-s.

Në pretendimin e tij lidhur me nenin 7 të LPP-s, nuk është respektuar nga ana e AK-s, nuk është e bazuar pasi që Operatori ekonomik edhe pse është i përgjegjshëm por i (pa suksesshëm) pasi ka dhënë çmimin e poentuar 20.90 € ku si O.E tenderues i përgjegjshëm është i treti me radhë për nga çmimi total i poentuar, ku Autoriteti kontraktues gjat dhënjes së vendimit të saj lidhur me procedurën e prokurimit të lartcekur ka aplikuar në përpikëri paragrafin 6 të nenin 7 të LPP-s që ka të bëjë me ekonomikitetin dhe efikasitetin e fondeve publike.

Gjithashtu O.E pretendon se nuk është zbatuar neni 56, kurse ne si AK kemi aplikuar në përpikëri nenin 56 prej fazes së pëpilimit të DT, kemi aplikuar të gjitha rregullat e LPP-s, rregullorës nr.001/2022 dhe Udhëzuesit Nr-001_2023 për prokurimin publik duke aplikuar nenin 51, 28 dhe 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-s, duke aplikuar nenin 58, ku në nenin 59 paragrafi 2 thotë qartazi AK mund të kërkojë me shkrim nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, ku ne si AK këtë paragraf e kemi zbatuar të D.T në neni 7.1 & 7.2 pika 2. me datën 17.07.2023 duke kërkuar sqarim me shkresën “ B47 Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit për TVSH” pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të O.E se AK ka bërë shkelje të RRUOPP-s konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit, konsiderojmë që është i pabazuar pasi që ne kemi aplikuar me përpikëri këtë nenin 59 të LPP-s gjatë vlerësimit si dhe kemi aplikuar me përpikëri edhe dispozitat e nenit 41 paragrafi 41.1, 41.2 dhe 41.12 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, duke ju përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Operatori ekonomik në pretendimin në fjalë i ngatron kushtet e pjesëmarrjes për të qenë i përgjegjshëm si O.E me kriteret e dhënjes së kontratës. Duhet të sqarojmë që kriteri i dhënjes së kontratës është përcaktuar në nenin 60 të LPP-s dhe me rastin e shpalljes së njoftimit për kontratë, është përcaktuar shumë qartë në DT dhe Njoftimi për Kontratë i cili ka qenë “ tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas poentimit”. Ndërsa kërkesat e pranueshmërisë dhe të kualifikimit janë kërkesa të cilat i përcakton AK për tu konsideruar një Operator Ekonomik si i përgjegjshëm për të shpërblyer me kontratë.

Në nenin 40.6 të Rregullorës 001/2022 për prokurim Publik është paraparë qartë:

Citat: ”Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Pretendim tjetër jo i saktë i O.E është se Grupi O.E i përfaqësuar nga lideri “ALPO SHPK” mungon Certifikata e TVSH-s. AK bazuar në UDHËZUESIN NR.001/2023 për Prokurim publik neni 10 paragrafi 10.1 ku është e paraqitur në menyren tabelare se nëse i mungon certifikata e TVSH, AK ka të drejt të kërkojë sqarim bazuar në nenin 66 të LPP-S, shih me posht:

Problemi	Si të veprohet ?	Neni i LPP-së
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkojnë informata sqaruese	66

Pretendim tjetër jo i saktë është kinse Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në përpikëri nenin 52 në DT ,nenin 56 ku është bërë vlersim profesional bazuar në kërkesat dhe kriteret e paraqitura në DT, pastaj në nenin 65 të LPP-S thotë asnjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i kompanisë fituese të tenderit, nuk ka marrë pjesë në pregatitjen e njoftimit për kontrat ose në pregatitjen të ndonjë pjese të DT, siq pretendon O.E ankues.

Sa i përket pretendimit dhe dyshimit të OE ankues që Gr i O.E i rekomanduar nuk i kanë përmbushur kërkesat në pikën 9.1&9.2 duke ofruar gjithësej stafin e kompletuar sikur është kërkuar nga AK, sqarojmë që komisioni vlerësues e ka kryer vlersimin në mënyrë profesionale duke e respektuar në përpikëri legjislacionin e prokurimit dhe pasi ka konstatuar që Gr. I O.E, të rekomanduar i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat, kanë rekomanduar për dhenien të kontratës dhe në si zyre të prokurimit, pasi kemi konfirmuar të dhenat, kemi aprovuar rekomandimin dhe kemi vendosur që të shpërblejmë me kontrat Gr. e O.E- Grup i Operatorëve Ekonomik ALPO SH.P.K.; Enggroup SH.P.K..

Pretendim tjetër i dyshimtë është në pikë 5 të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga O.E ankues i cili pretendon se nuk ju është bërë Njoftimi mbi eliminimin e tenderuesve – **SE A JENI NJOFTUAR ME SHKRIM LIDHUR ME ELEMENIMIN TUAJ NGA PJESMARJA E ME TUTJESHME NE**

AKTIVITETIN E PROKURIMIT O.E ankues thot (JO) ku nuk është e vërtet se AK me dt.15.05.2023 në kuader të B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me shkresë **B46 Letër standarde për tenderuesin e pasukseshëm e ka noftuar O.E ankues.**

Pretendim tjetër i dyshimtë është në pikë 2 të kërkesës për rishqyrtim te paraqitur nga O.E ankues ku thot se O.E ALPO SHPK ka dorëzuar me ofertën e tij dokumentin e vjetër të certifikates te biznesit, ku AK përmes atij numri identifikues fiskal përmes sistemit ja kemi dërguar shkesë **“ B47 Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit për TVSH” pra është identifikuar permes platformes se e-prokurimit pra edhe ky pretendim është i pa bazuara.**

Pretendim tjetër i dyshimtë është në pikë 3 të kërkesës për rishqyrtim te paraqitur nga O.E ankues kinse paramasa është plotësuar gabim. **Formula e cila është perdorur nga AK eshte ajo me 2 numra pas presjes dhjetore pasi që AK-ja ka përdorur sistemin excell ne kalkulim dhe automatikisht ka dal shuma 0.01 -Shih më posht formulën:**

29	4	Inqizimi detal i objekteve egzistuese-MAKINERIA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m2	1			- €
30	5	Inqizimi detal i objekteve egzistuese-UJESJELLESI DHE KANALIZIMI, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m2	1			- €
31	6	Inqizimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m³	1			- €
32	7	Inqizimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m³	1			- €
33	8	Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m²	1			- €
34	9	Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m²	1			- €
35	10	Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m²	1			- €
36	11	Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m²	1			- €
37	12	Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m²	1			- €
38	13	Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnazues i ujësjellësit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m³	1			- €
39	14	Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m³	1		0.03 €	=F39*30%
40						TOTALI (A) - 30% :	0.01 €

Vlen të theksohet se vlera e paraqitur nga O.E ankues 0.009 është e rumbullaksuar nga **sistemin excell** në formatin 2 numra pas presjes dhjetore që i bjen me qene vlera **0.01**.

Pretendim tjetër i dyshimtë është në pikë 7 të kërkesës për rishqyrtim te paraqitur nga O.E ankues është për **Kërkesën e përshtatshmërisë pra: Deklarat nën betim e cila dueht të jetë i plotësuar, i nënshkruar dhe e vulosur.Pra përcaktohet qart se - AI OPERATOR EKONOMIK I CILI E NENSHKRUAN DHE E VULOS DEKLARATËN** , pra fjala në këtë rast është për O.E **ALPO SHPK DHE ENNGGROUP SHPK,** pra që të dy e kan plotesuar rubrikat tek **identifikimi i O.E**

Citati: Unë i posht nënshkruari,

Unë, i posht nënshkruari, si dhe përfaqësuar [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj në betim se jam i përfundshëm në përputhje me Nenin 65 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 041-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 051-066 dhe ligjin Nr. 051-02.

Unë vëretoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderet dhe vëretoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjelbra dhe dënimeve, nëse unë për shkak të palqesë së dorëzimit të kësaj deklarate ose deklarata që përmban informata përmbajtëse të gabueshme ose mashtruese.

Unë, i posht nënshkruari, si dhe përfaqësuar [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj në betim se jam i përfundshëm në përputhje me Nenin 65 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 041-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 051-066 dhe ligjin Nr. 051-02.

Unë vëretoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderet dhe vëretoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjelbra dhe dënimeve, nëse unë për shkak të palqesë së dorëzimit të kësaj deklarate ose deklarata që përmban informata përmbajtëse të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)		Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	ALPO SH.P.K	Emri i OE:	Enggroup SH.P.K
Adresa e plotë:	Hajvali, Prishtinë	Adresa e plotë:	Prishtinë, Nesh Gashi, BH B6Ob 2.K-1 Lox 19
I përfaqësuar nga:		I përfaqësuar nga:	
Emri:	Behar Zeqiri	Emri:	Kreshnik SHEHU
Posta:	Drejtor	Posta:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.07.2023	Data:	11.07.2023
Vula:		Vula:	

Pretendim tjetër i O.E ankues është për kriterin (kërkesat e përshatshmërisë) ku bazuar në kalkulimin e ditëve Gr. O.E i rekomanduar e plotëson edhe këtë kriter pasi Vertetimet nga Gjykata janë valid deri 180 ditë , brenda validitetit të kërkuar në D.T.

Të nderuar ne si autoritet kontraktues jemi të thirrur dhe kemi kompetenca që ne rast të shpalljes, hapjes, vendimit për tender dhe gjatë gjithë procedurës tjetër, të veprojmë sipas legjislacionit në fuqi e cila rregullon fushën e Prokurimit, andaj edhe në këtë rast kemi ndjekur të gjitha hapat e kërkuara nga LPP-ja për procedurën në fjalë.

Ndërkaq sa i përket pretendimeve të parashtruara nga O.E ankues, konsiderojmë që nuk janë të bazuara, sepse sa i përket pretendimeve që kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar në përpikëri të gjithë procedurën. Në analizimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të çështjeve të cilat O.E. ankues i ka theksuar në kërkesën për rishqyrtim, aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP-s.


Andaj

Me qenë se Operatori Ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë duke mos pasur kurrfarë baze juridike në parashtrimin e kërkesës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, 23.08.2023

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimit
Komuna Mamushës



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.